



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E BRENDSHM

KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 327 prot

Tiranë, më 4 10 2022.

**VENDIM**

Nr. 5 datë 29/09/2022

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 29.09.2022**

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi, në mbledhjen e datës 29.09.2022 vendosi:

1. Për "Strategjinë Kombëtare të Rinis" 2022-2029", propozuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët", mbështetur në mendimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shprehu dakordësinë në parim.
2. Për projektligjin për "Reformën në sistemin e taksës së pasurisë", propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në mendimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shprehu dakordësinë në parim.
3. Për projektvendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 711 datë 29.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores" "Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë", propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë", anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Kreu II, pika 1 të përmirësohet si vijon: "Agjencitë e shërbimit funeral ..... Ky përmirësim dhe saktësim lidhet me vazhdimin e funksionimit të Agjencive të shërbimit funeral.
- Kreu II, pika 2 të riformulohet dhe saktësohet, si vijon: "Agjencitë e shërbimit funeral dhe Shtëpitë funerale me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret dhe kushtet për licencim brenda 6 muajve, sipas kritereve të miratuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore". Formulimi dhe saktësimi i pikës 2 është i domosdoshëm, pasi siç është formuluar është krejtësisht i pa saktë dhe i pa qartë.
- Kreu II, pika 3 të riformulohet (saktësohet), si vijon: "Nëse pas afatit 6 (gjashtë) mujor nga data e miratimit të rregullave të vendosura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencitë e shërbimit funeral nuk i plotësojnë kriteret dhe kushtet e vendosura, sipas nenit 36, shkronja "b", pika 2, ato nuk licencohen". Ky projektvendim nuk ka parashikuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, afatin e miratimit të kritereve dhe kushteve për funksionimin e Agjencive të shërbimeve funerale dhe Shtëpive funerale, duke krijuar një boshllék ligjor dhe zvarritjen e miratimit dhe plotësimit të kushteve dhe rregullave të tyre. Prandaj sugjerojmë të shtohet një pikë e veçantë që rrjedh nga ndryshimi i VKM nr.711, dt.29.10.2014, sipas projektvendimit të paraqitur, duke vënë afat për njësitë e vetëqeverisjes vendore duke e formuluar si vijon: Pika 4: "Njësitë e vetëqeverisjes vendore, brenda 6 (gjashtë) muajve duhet të miratojnë kriteret e kushtet për licencimin e Agjencive të shërbimit funeral dhe rregullat për funksionimin e tyre dhe të Shtëpive funerale".
- Titulli: "...e administrimit dhe funksionimit të varrezave në Republikën e Shqipërisë. Fjala "funksionim" mendoj të hiqet, ose të zëvendësohet me "organizim".
- Neni 36 pika 2: Agjencitë e shërbimit funeral licencohen nga bashkia..... Bashkitë duhet të udhëzohen mbi procesin e licencimit menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij VKM.
- Neni 36.5: bashkitë parashikojnë kritere dhe kushte për agjencitë .....MIE, MSSH dhe MB duhet të hartojnë setin me kritere dhe standardin minimal që të ndiqet nga bashkitë.
- Në lidhje me pikën e parë të projektvendimit i cili bën një shtesë në përkufizimet e përbajtura ne rregullore sugjerojmë që pika 22 të ketë përbajtjen si më poshtë: "Shtëpi funerale", është ndërtues apo një strukturë e posaçme përmes së cilës ofrohet kryerja e ritualeve të lamtumirës dhe riteve të tjera mortore në nderim të personave që kanë ndërruar jetë."
- Për sa i përket pikës së dytë të projektvendimit sugjerojmë që në riformulin e pikës 2 të nenit 36 të rregullores së miratuar me projektvendimin aktual, pas fjalëve "Agjencitë e shërbimit funeral" të shtohen fjalët "shtëpitë funerale".
- Mbi pikën 2 të nenit 36 do të ishte edhe një riformulim i nëndarjeve të tij duke i qartësuar ato sepse termat e përdorura "garanci e sipërmarrjes" apo "garanci e vazhdimësisë" dhe "përshtatshmërisë së shërbimit".
- Në pikën 3 dhe në pikën që do t'i shtohet këtij nenit 36 pas fjalëve "agjencitë e shërbimit funeral" të shtohen fjalët "shtëpitë funerale".

- Në pikën e dytë të projektvendimit me anë të së cilës shtohet pika 5 sugjerojmë që numri rendor “5” të zëvendësohet me numrin “4” për shkak se neni 36 në të cilin bëhet shtesa përmbylljet me pikën 3.
  - Në kreun II të projektvendimit sugjerojmë që kudo që përmenden fjalët “agjenci funerale” pas tyre të shtohen fjalët “shtëpi funerale”.
  - Pika 1 të kreut II duhet të hqet nga projektvendimi për shkak të kundërshtisë me pikat 2 dhe 3 të projektvendimit. Pra licencimi automatik bie ndesh me dhënien e afatit për plotësimin e kritereve që do të përcaktohen nga vetëqeverisja vendore.
  - Në pikën 3 të kreut II pas fjalëve “ato nuk licencohen” të shtohen fjalët “dhe vendosje pezullimi i ushtrimit të aktivitetit të tyre deri në plotësimin e kritereve dhe rregullave të përcaktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
4. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e rasteve për dhënien në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacionin përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Kreu III, pika 2 “Ndryshimi i kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në zonat e mbrojtura kur mbi këtë sipërfaqe miratohen vetëm veprimtari me interes kombëtar/publik si shtrimi i rrjeteve/ linjave/ tubacioneve dhe ndërtime të tjera infrastrukturore të përkohshme ose të përhershme, duke zbatuar parashikimet e ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” është një dispozitë jo e plotë që ka nevojë për rishikim nga pikëpamja e teknikës legjislative.
  - Kreu II i VKM parashikon rastet e dhënies në përdorim të fondit pyjor, duke specifikuar detyrimin që këto raste të janë ato të parashikuara në Nenin 25 të ligjit. Ndërkohë VKM shton edhe rastet që bëjnë përjashtim nga dhënia në përdorim që nuk gjijnë reference në ligj.
  - Në VKM e propozuar parashikohet mundësia e ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqeve të mbrojtura për projektet e infrastrukturës rrugore (ndërtimi i rrugëve). Kjo duhet të shihet e lidhur me Nenin 36 të ligjit “Për Pyjet” sipas të cilit konsiderohet kundërvajtje administrative “ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i veprimtarive që shkaktojnë degradimin dhe gjerryerjen e tokës si ndërtimi i rrugëve apo vepra ujore në fondin pyjor kombëtar. Ligji “Për Pyjet” parashikon vetëm detyrat e NJQV për dhënien në përdorim, ndërkohë që në VKM shtohet edhe kompetenca e NJQV për të shqyrtuar aplikimet dhe dhënë pëlqimin për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të sipërfaqeve pyjore në pronësi të pushtetit vendor ose subjekteve private.
  - Kreu IV “Procedura dhe dokumentacioni për dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar” nuk parashikon një procedurë të plotë e të qartë për subjektet duke deleguar kompetencat tek Ministri përgjegjës për nxjerrjen e udhëzimit përkatës.
  - Kreu V pika 6 parashikon mundësinë e lejimit të ndryshimit të kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në:
    - Pronësi të saj

- Pronësi private
  - Ndërkohë objekti i VKM lidhet vetëm me fondin pyjor publik/ kombëtar. Nuk parashikohet në objekt ndryshimi i kategorisë së përdorimit të sipërfaqes pyjore në pronësi private.
  - Duhet të shihet përputhshmëria midis Kreut V dhe Kreut VI të VKM-së. Në Kreun V përcaktohet procedura që ndiqet në rast të kërkesës për ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre. Në këtë procedurë, parashikohet se pas aplikimit NJQV bën reportin teknik dhe jep me shkrim dakordësinë (brenda afatit 30 ditor). Ndërkohë Kreu IV i kërkon këto dokumenta paraprakisht si pjesë të aplikimit në *e-albania*. Gjithashtu Kreu VI parashikon edhe marrjen e pëlgimit/ konfirmimin nga ana e Prefektit, gjë që nuk është e parashikuar në procedurë.
  - Kreu VII “Dispozita të fundit dhe kalimtare”, pika II mund të rishkruhet për të qenë më e qartë “...Për aplikimet e paraqitura në Ministri përpara hyrjes në fuqi të kësaj VKM, përfundojnë me procedurën e VKM 1353/2008
5. Për projektvendimin **“Për disa ndryshime në VKM nr.360 datë 29.04.2015, “Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre””**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në mendimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shprehu dakordësinë në parim.
6. Për projektligjin **“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”**, propozuar nga Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, mbështetur në mendimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shprehu dakordësinë në parim.

Znj. Romina KUKO  
Zv/Ministër i Brendshëm  
Bashkëkryetar



Z. Aldrin DALIPI  
Kryetar i Shoqatës së Këshillit  
të Qarqeve të Shqipërisë  
Bashkëkryetar

